



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MBROJTJES



29 SHTATOR - 5 TETOR
JAVA E MBROJTJES



KAPITULLI RI PËR MBROJTJEN CIVILE

Në Bazën Ajrore të Farkës u prezantua projekti i qeverisë për transformimin e Forcës Zjarrfikëse, që hap një kapitull të ri të Mbrojtjes Civile me fokus inovacionin në përballimin e fatkeqësive natyrore. Kryeministri Edi Rama garantoj dëmshpërblim të plotë për qytetarët e prekur nga zjarret e kësaj vere, ndërsa ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu theksoi se kjo nismë do të shtrihet përtej zjarreve, duke përfshirë edhe përmbytjet, tërmetet dhe emergjencat e tjera.

★★★★★



MINISTRI VENGU NË FORUMIN E SIGURISË SË VARSHAVËS

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu zhvilloi një vizitë zyrtare në Poloni, ku mori pjesë në Forumin e Sigurisë së Varshavës, ku dhe pati konsultime dypalëshe me homologun e tij polak Władysław Kosiniak-Kamysz. Gjatë takimit u vendosën piketat e bashkëpunimit në fushën e industrisë ushtarake dhe të fuqizimit të kapitalit njerëzor mes dy forcave të armatosura.

★★★★★

60-VJETORI I BATALIONIT TË MBËSHTETJES

Batalioni i Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura festoi 60-vjetorin e krijimit të tij. Në fjalën e tij përshëndetëse në ceremoninë e mbajtur me këtë rast, ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu theksoi se ky përvjetor përmbën një moment kulmor në historinë e njësisë. Ministri falënderoi komandantët dhe efektivistët ndër vite për profesionalizmin, përkushtimin duke theksuar se modernizimi dhe fuqizimi i njësisë mbeten objektivi i përhershëm.

★★★★★



STËRVIJA “STRONG EAGLE 10”

Batalioni i Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura festoi 60-vjetorin e krijimit të tij. Në fjalën e tij përshëndetëse në ceremoninë e mbajtur me këtë rast, ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu theksoi se ky përvjetor përbën një moment kulmor në historinë e njësisë. Ministri falënderoi komandantët dhe efektivet ndër vite për profesionalizmin, përkushtimin duke theksuar se modernizimi dhe fuqizimi i njësisë mbeten objektiv i përhershëm.

★★★★★



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MBROJTJES



STËRVITJE NË DETIN EGJE

Anija patrulluese “Lissus” P-133, pjesë e misionit në Detin Egje, ka zhvilluar një stërvitje në ujërat ndërkombëtare me qëllim përmirësimin e aftësive të ekuipazhit dhe gatishmërisë operationale. Stërvitja përfshiu testimin e mekanizmave, operationet e kërkim-shpëtimit në det, ndihmën e parë, procedurat e bordimit, si dhe veprimet kundër ujit e zjarrit në bord.

★★★★★

mod.gov.al

JM

PËRGATITJE PËR GARËN “CAMBRIAN PATROL 25”

Efektivët e Regjimentit të Këmbësorisë së Jugut po vijnë stërvitjen parapërgatitore në Chester, Mbretëria e Bashkuar, për garën prestigjioze “Cambrian Patrol 25”, që do të zhvillohet në Uells. Kjo garë ndërkombëtare është një nga më sfidueset dhe vlerësohet si një mundësi e rëndësishme për përgatitjen dhe aftësitë e trupave shqiptare.



GJENERALLEJTËNANT KINGJI NË CEREMONINË E KFOR

Gjeneralajtënant Arben Kingji mori pjesë në Kosovë në ceremoninë e marrjes së detyrës së komandantit të KFOR, gjeneralmajor Özkan Ulutaş. Ai theksoi se Forcat e Armatosura të Kosovës do të vazhdojnë kontributin e tyre ndaj Aleancës, duke mbështetur misionin e rëndësishëm për paqe dhe siguri në Kosovë dhe rajon.



Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë
Ceremonia e hapjes së lartëve
viti akademik 2025-2026

KOLEGJI I MBROJTJES DHE SIGURISË NIS VITIN AKADEMIK

Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë ka nisur vitin akademik 2025-2026 me një riorganizim të ri, hap ky vendimtar për forcimin e standardeve të arsimit ushtarak. Sistemi arsimor dhe stërvitor i Forcave të Armatosura do të funksionojë i integruar me Akademinë dhe Institutin e Kërkimit Shkencor Ushtarak, për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe përditësuar kurrikulat sipas zhvillimeve më të fundit.

★★★★★